



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KRYETARI

Nr. Prot

3732/2

Datë 03.12.2018

URDHËR

Nr. 2, datë 03.12.2018

**“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE RREGULLAVE TË HEDHJES SË
SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË
DREJTËSI (TË PËRKOHSHËM)”**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d dhe pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

URDHËROJ:

KREU I

**RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS SË
HEDHJES SË SHORTIT**

1. Miratimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).
2. Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) i nënshtrohet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi.
3. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimin e çdo faze të saj krijohet një Sekretariat Teknik. Numri i anëtarëve dhe përbërja e Sekretariatit Teknik caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.
4. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë cakton datën dhe orën e organizimit të shortit. Data dhe ora e organizimit të shortit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

5. Kryetari i Kuvendit njofton zyrtarisht për datën dhe orën e organizimit të shortit, Prokurorin e Përgjithshëm, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, të cilët ftohen të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për të qenë prezent në organizimin e shortit.
Përfaqësuesit e këtyre institucioneve të caktuar për të marrë pjesë në organizimin e shortit nuk duhet të jenë të njëjtë me personat e përfshirë në listën e kandidatëve të paraqitur për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).
6. Për zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit njoftohet dhe ftohet të marrë pjesë si vëzhgues: Avokati i Popullit, Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, organizata partnere ndërkombëtare dhe media.
7. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Sekretariati Teknik sigurohet paraprakisht për praninë e:
 - a. përfaqësuesve të dërguar nga institucionet e përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
 - b. Avokatit të Popullit ose të përfaqësuesit të autorizuar prej tij;
 - c. Përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të organizatave partnere ndërkombëtare, në cilësinë e vëzhguesve;
 dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.
8. Mosparaqitja e përfaqësuesve të institucioneve të përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nuk pezullon procedurat e hedhjes së shortit.

KREU II PROÇESI I HEDHJES SË SHORTIT

9. Shorti organizohet në dy kuti transparente. Në njëërën prej kutive vendosen goglat dhe në kutinë tjetër vendosen shiritat e letrës, ku janë shënuar emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion sipas listës së përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.
10. Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve futen në gogla. Numri i goglave duhet të përputhet me numrin e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës së përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.
11. Rradha e futjes së goglave në kuti dhe rradha e hedhjes së shortit përcaktohet duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:
 - a) kandidatë të Gjykatës Kushtetuese;
 - b) kandidatë të Gjykatës së Lartë;
 - c) kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme;
 - ç) kandidatë nga gjykatat e apelit;
 - d) kandidatë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;

dh) kandidatë nga gjykatat administrative.

12. Një nga anëtarët e Sekretariatit Teknik, i ndryshëm nga anëtari që futur shiritin e letrës në gogël, tërheq nga kutia përkatëse me rradhë goglat.
Anëtari i Sekretarit Teknik pasi e hap goglën, e lexon me zë të lartë emrin e kandidatit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm), që është i shënuar në të dhe ia tregon të gjithë pjesëmarrësve.
Shiriti i letrës që gjendet brenda saj, i dorëzohet Sekretariatit Teknik.
13. Kandidati, emri i të cilit është shënuar në shiritin e letrës, do të jetë anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).
14. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, të parashikuar nga pikat 9 deri në 13 të këtij urdhri, zgjidhet edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
15. Pas tërheqjes së goglave nga anëtari i Sekretariatit Teknik, kutia transparente zbrazet dhe në të futen goglat me emrat e kandidatëve të dërguar nga institucioni tjetër sipas rradhës së caktuar në pikën 11 të këtij urdhri.
16. Rezultati i shortit shpallet nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë.
17. Procedura e hedhjes së shortit regjistrohet në audio dhe video.
18. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së organizimit dhe hedhjes së shortit sipas parashikimeve të këtij urdhri mbahet procesverbal.
19. Rezultatet e shortit së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.
20. Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit.
21. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Sekretariati Teknik për ndjekjen e procedurave të nevojshme të zbatimit të këtij urdhri.
22. Urdhri nr. 1, datë 22.11.2017, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

